

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren



Fakulteti i Filologjisë, Prizren

PROGRAMI MËSIMOR

Niveli i studimeve	Bachelor	Programi	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	Viti akademik	2017/2018	
LËNDA	Hyrje në gjuhësi					
Viti	I parë	Obligative	Kodi	ECTS	6	
Semestri	Dimëror					
Javët mësimore	15 (pesëmbëdhjetë)		Orët mësimore		Ligjërata	Ushtrime
					3	1
Metodologjia e mëimit dhe përshkrimi i lëndës	<p>Lënda Hyrje në gjuhësi ka si objektiv të saj studimin dhe krahasimin e vendit të gjuhës (shqipe) me shkencat e ndryshme shoqërore, me veçoritë, konceptet e gjuhës dhe të funksionit të saj. Si bosht studimi apo bërthamë ka përshkrimin e fonetikës nyjëtimore, akustike, funksionale; semantike; gramatikore etj. Kjo lëndë si shkencë shoqërore (gjuhësia) studion gjuhën, e cila është një dukuri e pandarë nga veprimtaria e përditshme e njeriut.</p> <p>Detyrat e saj janë të shumta duke i përfshirë ato teorike dhe praktike. Objekti i studimit gjuhësor mund të bëhet gjuha e folur dhe e shkruar; materia e gjuhës ose përmbajtja e saj; funksionimi i saj në një bashkësi gjuhësore të dhënë në një epokë historike të saj.</p>					
Konsultime						
Mësimdhënësi	Prof.asoc.dr. Shkëlqim Millaku		e-mail	shkelqim.millaku@uni-prizren.com		
			Tel.	044-886466		
Asistenti			e-mail			
			Tel.			
Qëllimi studimor i lëndës			Përfitimet e studentit			
<p>Kursi do t'iu ndihmojë studentëve për të njohur drejt dhe saktë funksionin dhe rëndësinë e gjuhës në shoqëri. Nga ky kurs, studentët parapërgatiten për të hyrë në karrierën e tyre të gjuhësisë, të cilët, do të jenë të kompletuar profesionalisht pasi që kanë arritur objektivat e qëllimit të lëndës Hyrje në gjuhësi. Kursi do të përfshijë mësimin teorik dhe praktik. Ai do të përfshijë shkrimin dhe leximin e punimeve, prezantimeve me shkrim gjatë orëve mësimore dhe detyrave studimore, hulumtuese të shtëpisë.</p>			<p>Studentët do të jenë në gjendje:</p> <p>Studentët do të jenë në gjendje të demonstrojnë shkathtësi në procesin e të shkruarit për gjuhën, gjenerimin e ideve, përgatitjen e drafteve, rishikimi, editimi dhe prezantimi. Ata do të jenë në gjendje të shkruajnë për qëllime të ndryshme (tregime, shpjegime, argumentime dhe pikëpamje të caktuara, analiza dhe sinteza të ideve). Studentët do të jenë në gjendje t'i përshtatin tekstin e tyre publikut të ndryshëm të lexuesve (profesorë, prindër të fëmijëve që i mësojnë, moshatarëve dhe publikut më të gjerë). Studentët do të dinë se aftësia për të shkruarit dhe studiuarit mirë është shkathtësi esenciale për komunikim dhe nxënie. Gjithashtu do të mësojnë se</p>			

<p>Qëllimi i lëndës është që ta informon studentin me studimin bërthamë për gjuhën.</p> <p><i>Njohja e thellë</i> e objektivave dhe koncepteve fonetike, morfologjike, të klasifikimit të gjuhëve dhe pozicionin e gjuhës me shoqërinë apo edhe për prejardhjen e gjuhës, kulturës etj, kompletojnë konceptin e informacionit hyrëse për profesionin e tyre të gjuhësisë.</p> <p>Qëllimi i kursit është që studenti do të arrin t'i ndërton themelet e shëndosha efektive dhe efikase, dhe të fuqishme në përfundim të studimit të gjuhës, por edhe të raportit të saj me disiplina të tjera gjuhësore dhe jo gjuhësore.</p>	<p>si do të mund t'u ndihmojnë fëmijëve, studentëve që të zhvillojnë shkathësi e të mësuarit, shkruarit dhe komunikuarit në klasat e tyre për gjuhën.</p>
--	---

Metodologjia për realizimin e temave mësimore:

Ligjëratat do të organizohen në modelin interaktiv apo të kombinuara, si: shpjegim – sqarim, ushtrime, analiza tekstore e shkencore, diskutime, punë në grupe, demonstrime dhe interpretime, shtruarje e shqyrtim idesh, hartime krijuese, vetë hulumtuese etj. Këto do të jenë pjesë kryesore për punën e vlerësimit dhe mënyrën apo metodologjinë e të ligjruarit.

Kushtet për realizimin e temës mësimore:

Varësisht nga tema mund të organizohen dhe realizohen përmes komunikimit interaktiv, ligjëratat në modelin klasik, përmes (kompjuterit dhe projektorit) etj. Këto edhe mënyra të tjera të ligjruarit kërkojnë kushte të mira si ndriçim në klasë, numër i studentëve të jetë sipas standardit të paraparë, të kemi internet dhe elemente të tjera elektronike, të cilat mundësojnë realizimin e koncepteve teorike dhe atyre praktike.

Mënyra e vlerësimit të studentit (në%)

<p>Vlerësimi do të bëhet duke u mbështetur në, vlerësimet me shkrim (dy teste gjatë vitit akademik), seminare, detyra të shtëpisë, angazhime në klasë dhe në testin përfundimtar.</p> <p>Pikët e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Testi i parë: 1-30 pikë 2. Testi i dytë: 1-30 pikë 3. Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 1-20 pikë 4. Vlerësimi i fundit testi përfundimtar (pyetje-përgjigje gojarisht): 1-20 pikë. 5. Totali: 100 pikë 	<p>Vlerësimi në %</p>	<p>Nota përfundimtare</p> <p>Vlerat e pikëve:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. 50-60 = 6 2. 61-70 = 7 3. 71-80 = 8 4. 81-90 = 9 5. 91-100 = 10 <p>Studentët me rezultat të përgjithshëm nën 50 pikë nuk mbërrijnë notën kaluese.</p>

Obligimet e studentit: Të jenë pjesëmarrës aktiv, t'i kryen seminaret; prezantimet dhe hulumtime të pavarura (jashtë plan-programit) me sukses.

Gjatë ligjëratave nuk u lejohet komunikimi me telefon apo modele të tjera, të cilat pengojnë procesin e mësimit.

Gjatë organizimit të testeve nuk lejohet kopjimi, komunikimi apo ardhja më vonë, sepse do të pengojnë procesin e

organizimit të testit.

Testet apo provim organizohet sipas plan-programit të paraparë dhe zgjatë një orë mësimore.

Ligjërata

Në ligjërata studentët duhet të jenë pjesëmarrës aktiv, të kompletuar dhe të përgatitur me pajisje mësimore, dhe studimore për ta kuptuar dhe realizuar temën e dëgjuar apo plan-programin e lëndës.

Ushtrime

Do t'i ushtrojnë dhe demonstrojnë temat e dëgjuara nga ligjërata dhe shembujt do t'i planifikojmë kryesisht nga tekstet shkencore dhe ato shkollore në mënyrë që pas mbarimit të ligjëratave studentët të kenë mundësi për t'i praktikuar lirshëm lidhshmërinë e gjuhës me gjuhësinë. Studentët janë të obliguar të kenë fletore pune për t'i ushtruar temat, të cilat i kanë pasur si ligjërata dhe për t'i prezantuar apo demonstruara ato në mënyrën e tyre të thjeshtë dhe praktike. Kjo do të jetë e obliguar nga se cili student për t'i prezantuar dhe praktikuar njohurit e tyre për temat e mësuara (...).

Ngarkesa e studentit për lëndën

Aktiviteti	Orë	Ditë	Javë	Gjithsej
Ligjërata	3	1	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	1	1	15	15
Punë praktike				
Kontakte me mësimdhënësin/konsultime	2	1	15	16
Ushtrime në terren				
Seminare, teste, kolokfiume etj.	4	2	2	8
Detyra të shtëpisë	3	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	5	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim	9	1	3	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, në provim final)	7	3	3	7
Projekte, prezantimet etj.		1	1	1
Totali				150 150:25=6 ETCS 6

Java	Ligjërata		Ushtrime	
	Tema	Orët	Tema	Orët
1.	Gjuhësia dhe objekti i saj, Testimi i njohurive për gjuhësinë, Vendi i gjuhësisë në shkencat shoqërore, Konceptimi dhe orientimi për studimin e gjuhësisë.	3		1
2.	Prejardhja e gjuhës, Gjuha dhe kultura.	3		1
3.	Gjuha, veçoritë dhe funksioni i saj, Koncepti themelor i gjuhësisë.	3		1
4.	Objekti studimor i fonetikës, a. nyjëtimore, b. akustike, Funksionale.	3		1
5.	Përkufizimi i fjalës, Leksikologjia, Leksikografia, Test	3		1
6.	Semantika leksikore, Polisemia, Homonimia, Antonimia, Sinonimia, Etimologjia.	3		1
7.	Sistemi gramatikor i gjuhës, Rendi i fjalës, Numri, Gjinia, Rasa,	3		1

	Koha, aspekti, mënyra etj.			
8.	Klasifikimi i gjuhëve, Familjet e gjuhëve.	3		1
9.	Gjuha si dukuri shoqërore, Dialekti, Gjuha, Variantet, Dygyhësia.	3		1
10.	Test	3		1
11.	Gjuha dhe kompjuteri, Leksikografia kompjuterike.	3		1
12.	Dorëzimi dhe prezantimi i seminareve, Gjuhësia historiko – krahasuese.	3		1
13.	Koncepti themelor i gjuhësisë, Gjuha dhe shkrimi, Gjuha dhe zgjerimi, Kodi, shenja dhe mesazhi, Sinkronia dhe diakronia gjuhësore.	3		1

14.	Hipoteza e Chomskit, Gjuha dhe truri, Historia e gjuhësisë (Greqi e lashtë, Roma, Mesjeta, Rilindja, epoka moderne etj).	3		1
15.	Përmbledhja e lëndës Hyrje në gjuhësi, Prezantimet e hulumtimeve gjuhësore.	3		1

LITERATURA

Rami Memushaj, **Hyrje në gjuhësi**, Tiranë, 2002
 Robert Robins, **Historia e gjuhësisë**, Tiranë, 2007

E. Çabej, **Studime gjuhësore III**, Prishtinë, 1977
 A.Martine, **Elementet e gjuhësisë së përgjithshme**, Prishtinë, 1974
 N. Chomsky, **Studimet sintaksore**, Paris, 1971 (2011, përkthyer nga Shkelqim Millaku)
 F.dë Sosyr, **Kursi i gjuhësisë së përgjithshme**, Prishtinë, 1977
 Shkelqim Millaku, **Kërkime gjuhësore**, Prishtinë, 2015

VËREJTJE